

FJALA E DEPUTETES HATIXHE KONOMI

E ENJTE 24 SHKURT 2022

E nderuara Kryetare,

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare për Kontrollin e Dëmit nga Sistemet për Mbrojtjen Antivegetative në anije (anti-fouling), 2001”, propozuar nga Këshilli i Ministrave, na vjen sot në kuadër të detyrimeve që ka Shqipëria për aderimin në të gjitha konventat ndërkombëtare në fushën e detarisë, ndryshimeve të tyre dhe rezolutave të Organizatës Ndërkombëtare Detare, si anëtare e saj, për plotësimin e standardeve ndërkombëtare në fushën e detarisë. Projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe, konkretisht, me nenin 121, ku përcaktohet se ratifikimi dhe denoncimi i marrëveshjeve ndërkombëtare nga Republika e Shqipërisë bëhet me ligj në rastet kur ato kanë të bëjnë me miratimin, ndryshimin, plotësimin ose shfuqizimin e ligjeve, si dhe me nenin 18 të ligjit nr. 43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”. Komisioni i Politikës së Jashtme, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, e diskutoi këtë projektligj dhe të gjithë anëtarët e pranishëm në mbledhje e mbështetën dhe votuan pro ratifikimit të kësaj marrëveshjeje.

Qëllimi i projektligjit Në kontekstin e përgjithshëm të zhvillimit, roli i anijeve është shumë i rëndësishëm dhe me një kontribut të jashtëzakonshëm në tregtinë globale, por, natyrisht, ashtu siç kanë kontributin, ato kanë edhe ndikim në mjedis, kryesisht në mjedisin global dhe atë detar. IMO, Organizata Ndërkombëtare Detare, si një agjenci e specializuar e Kombeve të Bashkuara, me përgjegjësi për sigurimin e transportit detar, trajton rastet e ndotjes nga anijet, duke marrë edhe një gamë të gjerë masash për parandalimin dhe kontrollin e ndotjes së shkaktuar nga anijet. Në mënyrë të veçantë më 18 tetor të vitit 2001 u mbajt një konferencë prej saj, ku u miratua konventa ndërkombëtare për kontrollin e dëmit nga sistemet për mbrojtjen antivegetative në anije (anti-fouling), 2001. Ky projektligj që po diskutojmë sot synon pikërisht ratifikimin e kësaj marrëveshjeje, e cila ka për qëllim të reduktojë ose të eliminojë efektet negative në mjedisin detar dhe shëndetin e njeriut, të shkaktuara nga sistemet e mbrojtjes antivegetative për anijet, anti-fouling. Ky projektligj vjen edhe në zbatim të konventës rajonale dhe ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe biodiversitetit.

Pa dashur të zgjatem në detaje, sepse ato u sqaruan edhe nga ministrja e Energjisë dhe Transportit, dua të theksoj edhe një herë sa e rëndësishme dhe sfiduese mbetet sot për çdo vend të planetit tonë mbrojtja e mjedisit dhe, në mënyrë të veçantë atij detar. Prej vitesh studimet shkencore kanë treguar që disa sisteme për mbrojtjen antivegetative, të përdorura për anijet, paraqesin rrezik të konsiderueshëm të lëndëve toksike dhe ndikime të tjera kronike për organizmat detarë të rëndësishëm në aspektin ekologjik dhe ekonomik, duke dëmtuar, gjithashtu, shëndetin e njeriut, si

rezultat i konsumit të ushqimeve të detit të kontaminuar. Prandaj, reduktimi i ndotjes së shkaktuar prej këtyre sistemeve është jo vetëm domosdoshmëri, por edhe detyrim për çdo shtet zotërues të hapësirave detare. Në lidhje me konventën, dua të vë theksin se kjo konventë ndalon përdorimin e organotivave të dëmshme në bojërat kundër ndotjes të përdorura në anije dhe vendos një mekanizëm për të parandaluar përdorimin e mundshëm të substancave të tjera të dëmshme në të ardhmen në sistemet antindotje. Bojërat kundër ndotjes përdoren për të veshur fundet e anijeve për të parandaluar vrasjen e jetës së detit, siç janë algat dhe molusqet, që bashkohen me trupin, duke ngadalësuar anijen dhe duke rritur konsumin e karburantit. Studimet kanë treguar se këto përbërje vazhdojnë në ujë, duke vrarë jetën e detit, duke dëmtuar mjedisin dhe ndoshta duke hyrë edhe në zinxhirin ushqimor. Konventa përcakton sistemet kundër ndotjes, si një shtresë, bojë, trajtim sipërfaqësor ose pajisje që përdoret në një anije për të kontrolluar ose parandaluar lidhjen e organizmave të padëshiruar.

Gjithashtu, dua të theksoj se përdorimi i sistemeve të mbrojtjes antivegetative për anijet, për parandalimin e krijimit të organizmave në sipërfaqen e anijeve, ka një rëndësi kritike për efikasitetin e tregtisë, transportit dhe pengimin e përhapjes së organizmave të dëmshëm ujorë dhe patogjenëve. Sipas kushteve të konventës, palëve në konventë u kërkohet të ndalojnë dhe/ose të kufizojnë përdorimin e sistemeve të dëmshme antindotje në anijet që mbajnë flamurin e tyre, në anijet që nuk kanë të drejtë të mbajnë flamurin e tyre, por që veprojnë nën autoritetin e tyre, si dhe të gjitha anijet që hyjnë në një port, kantier detar, ose terminal në det të një pale. Gjithashtu, konventa përfshin edhe një klauzolë, e cila thotë se një anije do të ketë të drejtë për kompensim nëse ndalohet ose vonohet padrejtësisht ndërsa i nënshtrohet inspektimit për shkelje të mundshme të konventës. Sa u takon efekteve financiare, sqaroj se miratimi i këtij projektligji nuk do të sjellë efekte financiare për buxhetin e shtetit, që ministrja i sqaroi më së miri. Prandaj, në këtë kuadër, të nderuar kolegë, ju ftoj ta mbështesim dhe votojmë këtë projektligj. Faleminderit!